
DOKUMENTE E MATERIALE

**SHËNIME RRETH ÇËSHTJES VLLAHE.
ÇËSHTJA VLLAHE DHE KONFERENCA E LONDRËS
(Pjesa e parë)**

Në Konferencën e Fuqive të Mëdha në Londër, çështja vllahe u diskutua në ditën 5 gusht 1913. Qe ambasadori i Austro-Hungarisë që, me rastin e pranimit të pesë pikave që parashtrioi Sër Eduard Grei në mbledhjen e mëparshme (Jugë e Shqipërisë dhe Ishull i Korfuzit) brenda rezervave të tjera shtroi atë që lidhej me vllahët duke e formuluar në mënyrën që pason: “Lidhur me kuco-vllahët ai kërkon (kabineti i Vjenës) vendosjen ndër masat që do të merren e një dispozicioni që do t’i njihte Rumanisë mundësinë për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e kuco-vllahëve”^{*}.

2. Eduard Grei nënvizoi që *meqenëse Rumania dhe Greqia janë [mungon] u takon të merren vesh për garancitë që do t’u falin kuco-vllahëve në territoret e aneksuara Greqisë dhe pa nevojë që fuqitë ta marrin inisiativën*^{**}.

Në mbledhjen pasuese (8 gusht 1913) çështja u kthye në diskutim meqenëse Ambasadori i Austro-Hungarisë vuri pranimin e disa pikave si kusht për pranimin e formimit të një Komisioni Ndërkombëtar për caktimin e kufirit jugor shqiptar. Nga këto pika e gjashta thoshte: në zonën e banuar nga vllahët Komisioni do të konstatojë kombësinë e tyre, qoftë Shqipërisë, qoftë Shqipërisë, qoftë Greqisë, do të formojë objektin e një marrëveshjeje të drejtpërdrejtë midis Greqisë dhe Rumanisë^{***}.

Duke iu përgjigjur deklaratave të Ambasadorit të Austro-Hungarisë, Eduard Grei vinte re që me diksionin e propozuar synohej që t’u hiqej Fuqive caktimi i krahinës [mungon] kucovllahe dhe i lihej në dorë Greqisë dhe Rumanisë “ai e ka propozuar tashmë se mund të lihen këto dy fuqi [të merren vesh?] drejtpërdrejtë mbi garancitë për t’u dhënë popullsisë së krahinave është e udhës të lihet çështja e përcaktimit të caqeve të territorit në dorën e fuqive. Si rrjedhojë ai propozon redaktimin që vijon: Sa për zonën e banuar nga kuco-vllahët Komisioni duhet të konstatojë kombësinë e tyre. A do t’i takojë, qoftë

^{*} Frëngjisht në origjinal (shën. i përkth.) [shkrimi me italike është i imi – shën. i përkth.].

^{**} Frëngjisht në origjinal.

^{***} Frëngjisht në origjinal. *Archivio Storico Diplomatico di Ministero Affari Esteri*, Roma (më tej: *AMAE*), Fondi: Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Pacco 7 (marrë nga *Arkivi i Institutit të Historisë*, image 2147).

Shqipërisë, qoftë Greqisë, do ta vendosin Fuqitë pas raportit të Komisionit Ndërkombëtar. Sa për garancitë që u duhen dhënë popullsisë kuco-vllehe kjo do të jetë objekt i një marrëveshjeje të drejtpërdrejtë midis Greqisë dhe Rumanisë*.

Ky amendament pranohej ditën 11 gusht 1913 nga ambasadorët.

Çështja vllahe dhe Komisioni Ndërkombëtar për caktimin e kufirit jugor shqiptar – Udhëzimet që [mungon – mbase përfaqësuesit] e Fuqive të ndryshme në Komisionin Ndërkombëtar për caktimin e kufijve jugorë shqiptarë morën e kishin bazën te amendamenti i lartpërmendur.

Komisioni duhet ta niste veprimin [ditën] e parë ... përkundrazi [mungon] luginat malore qoftë sepse tani stina e bënte të pamundur të vizitoheshin krahina zakonisht mezi të përshkueshme, qoftë se popullsia që ishte kushtuar blegtorisë, kishte filluar tashmë shtegtimin periodik ndaj kullotave dimërore të Thesalisë dhe të Çamërisë. Ky ekzaminim për çastin u la mënjanë dhe u caktua për më vonë dhe filluan punimet që i takonin kontestimit greko-shqiptar.

Po edhe këto punime, pjesërisht për synimet greke, pjesërisht për qëndrimin e delegatëve të Rusisë dhe të Francës, më në fund u ndalën dhe dukej se tani mund të shpresohej në një rezultat praktik të tyre, kur delegati anglez, koloneli Dati Uilis bëhej iniciator i një propozimi që ia nënshtonte qeverisë së vet duke treguar një linjë kufiri që mund të formonte bazën e një kuptimi të përgjithshëm.

Qeveria angleze, duke e bërë të vetin propozimin e delegatit të saj ia komunikonte kabinetëve të ndryshme. Po në tekstin e komunikimit përfshinte frazën që pason: *“Vllehët, sipas marrëveshjes së propozuar, do t’i kalojnë Greqisë”***.

Qeveritë e Austro-Hungarisë dhe Italisë, duke iu përgjigjur shënimit anglez, përveç rezervave që lidheshin me pika të tjera, formulonin një të tillë lidhur me vllehët, të redaktuar në mënyrën që pason *“Çështja e territorit të banuar nga kuco-vllehët le të bëhet objekt i një marrëveshjeje të drejtpërdrejtë midis Greqisë dhe Rumanisë veçse të përcaktohet që tani se bisedimet që synojnë këtë marrëveshje nuk i japin Greqisë të drejtën për të vonuar përtej 31 dhjetorit të vitit në vazhdim, zbrazen e pjesës tjetër të territorit shqiptar”****.

Pra në rast se nuk arrihet asnjë marrëveshje midis Rumanisë dhe Greqisë, çështja mbetet në këtë pikë.

Lajme përmbledhëse mbi vllehët e Pindit dhe Gramozit

Popullsia e racës latine që banon në krahinat të cilat vareshin deri vonë nga Perandoria Otomane njihet me emra të ndryshëm. Ajo u quajt “latina ginte” (gjindje latine). Individët e veçantë që u pyetën e quajnë veten “arumunë”. Disa

* Frëngjisht në origjinal.

** Frëngjisht në origjinal.

*** Frëngjisht në origjinal.

grupe të tyre kanë emërtime të ndryshme si, bie fjala cicarët (nga cincì – cinque – pesë, mbase nga ushtarët e legjionit të pestë), farsaljtët (me origjinë nga të mundurit e Farsaljes), rakaçanët e të tjerë. Turqit i quajnë të gjithë “vlllehë” dhe grekët kanë gjetur për ta fjalën “kuco-vlllehë” që tingëllon si tallje dhe s’do të duhej të përdorej.

Koloni nga këta arumunë gjenden nga pak kudo në territoret që kanë qenë dikur otomane dhe fshatrat e tyre që dallohen për qëndrueshmërinë dhe një farë elegancë të ndërtesave, për mirësjelljen e banorëve, të qetë, në gjendje të mirë financiare, që merren me tregti dhe blegtori dhe për institucionet e tyre civile dhe prandaj tregojnë një progres më të madh se popullsitë midis të cilave jetojnë, pothuajse gjithmonë janë të vendosura në pozicione ushtarake, në nyjet malore dhe rrugore që mbizotërojnë në lugina dhe komunikacione.

Po ekzistojnë dy rajone në të cilat janë grupuar shumë prej tyre që iu japin si pasojë fizionominë e tyre të veçantë. Edhe sot të paktën njëra nga ato krahina mund të quhet vllahe se as përpjekja për natyralizim e bërë me të gjitha mënyra dhe të gjitha mjetet nga grekët, as persekutimet, as masakrat s’kanë arritur ta zhdukin racën.

Këto krahina janë ato që marrin emrin nga vargmalet e Gramozit dhe të Pindit.

Dhe përveç popullsisë të vendosur në mënyrë të qëndrueshme në to duhet pasur parasysh se një tjetër po aq dhe mbase edhe më e madhe në numur, qëndron aty gjatë stinës së mirë dhe çon aty grigjën dhe bagëtinë për të kullotur.

Këto krahina janë dhjetë. Ato gjenden të gjithë nga ana e administratës në territorin e sanxhakut të lashtë të Korçës, qytet kryesor që është banuar në pjesën më të madhe nga populli e racës rumune. Meqenëse Konferenca e Londrës i ka caktuar Shqipërisë zonën e kazasë së Korçës, një pjesë e fshatrave vlllehë është fituar kështu nga shteti i ri dhe një pjesë tjetër ka mbetur në krahinat e kontestuara që Komisioni Ndërkombëtar do të duhej të vizitonte. Emrat e këtyre fshatrave janë ato që pasojnë:

Korça, Slipista, Grabova, Niçea, Lanka, Plasa, Vithkuqi, Nikolica, Moskopoli, Gramosia.

Disa nga këto vise kanë qenë dikur të mbipopulluara dhe patën një të kaluar të denjë për kujtesë, po kanë qenë djegur e shkatërruar në pjesën më të madhe dhe popullsia e tyre emigroi në krahina të tjera, sidomos në rrethet e Manastirit dhe Hungarisë. Ashtu ndodhi me Moskopolin që numëronte 60.000 banorë, i shkatërruar nga çeta të udhëhequra nga i ati i Ali Pashait të Tepelenës; ashtu ndodhi me Nikolicën, Gramosjen, Vithkuqin dhe qendra të tjera.

Sot, ndonëse është ende fjala për mjaft të populluara, s’mund të thuhet që vlllehët të mbizotërojnë në krahinë, të përzier siç janë me sllavë, shqiptarë dhe pre siç janë të përçarjeve fetare e politike greke.

Në krahinën e Pindit gjenden plot 36 fshatra që kanë ruajtur veçoritë e racës rumune. Ato në varësi nga vargmalet dhe luginat që i grupojnë mund të rreshtohen si vijon:

Zagori	Vjosë	dhe Smolikë	Vllahi	
Kavalari	Vovusa	Briaza	Baltinon	Smiksi
Tratoniku	Laka	Armata	Çuçuflani	Samarina
Grebeniti	Paliohori	Pac	Milja(Ameru)	Bozove
Flamburari	Losnik	Paliosali	Kranja	
Dragari	Dobrinove	Grizbani	Boblona	
Makrini			Labanika	
Çerneshi			Parivoli	
Seshini			Avdela	
Sarandaporos				
Furka				
Donçikë				
Lupeik	(pjesërisht)			
Çerasovë	(idem)			
Zona e Mecovës				
Mecovë	Votonoshi			
Votonoshi				

I denjë për referim është fakti se popullsitë vllahe të krahinës së Zagorisë kanë qenë ato që kanë vuajtur më shumë nga pasojat e propagandës greke. Mbase kontribuoi për këtë fakti i skllavërisë që duhet të duronte domosdoshmërisht kjo krahinë në çdo shfaqje nga ana e Janisë, qendër rrezatuese e veprimit helen. Është fakt se nën një presion të tillë ajo popullsi ka humbur shumë nga përkushtimi ndaj çështjes kombëtare rumune. Shumica e tyre përdor prej mjaft vjetësh pothuajse ekskluzivisht gjuhën greke, kështu që gjuha vllahe humbet gjithnjë e më tepër terren. Diçka e rëndësishme dhe për t'u vënë re se në këtë krahinë dhe në ato pranë shumë fshatra përveç atyre që janë marrë në konsideratë dhe përmendur më lart, kishin ruajtur deri pak vjet më parë karakterin e tyre rumun, ndërsa tani as që e kuptojnë më të folem vllehe (Çepelovë, Skambeli, Sapuçeli etj.) ose e kuptojnë pak (Doliani, Leskovik etj.). Në krahinën vllehe gjenden fshatrat më të rëndësishme dhe krejt vllehe nga të cilët disa (Samarina, Avdela, Perivoli), shumë të rëndësishme dhe aq të populluara sa formojnë vetë më shumë se gjysmën e tërë kazasë së Grebenesë ku gjenden. Popullsia ka ruajtur tërë veçoritë etnografike në gradën më të lartë dhe ka një përkushtim të madh ndaj çështjes kombëtare rumune. Gjuha greke flitet vetëm nga pak veta dhe është krejt e panjohur për shumicën.

Këto popullsi kanë bërë vite me radhë një luftë të egër kundër presioneve dhe prepotencave duke arritur madje në përdorimin e çetave kombëtare të armatosura kundër atyre që propaganda greke çonte në Pind për ta terrorizuar

krahinën, gjë kjo tepër e çuditshme po të mendohet për traditat paqësore dhe të buta të gjindjes vllahe.

Ka qenë për to dhe për krimet e kryera aty nga çetat greke (masakra e Avioles) që çështja e përgjithshme vllehe para pak viteve arriti gradën më të lartë të ashpërsisë dhe e bëri Rumaninë të vendoste për të çuar deri në fund veprën e vet në favor të autonomive lokale për vllahët otomanë duke kompromentuar madje marrëdhëniet e veta me Greqinë.

Të njëjtat pohime mund të bëhen për fshatrat e rrëzës jugore të masivit të Omolikës ndonëse popullsia e tyre nuk e shfaq atë përkushtim po në atë gradë.

Në përgjithësi mund të pohohet se tërë popullsia vllehe e ndjen origjinën e vet të ndryshme me atë të popullsisë që e rrethojnë dhe që kudo, veçanërisht gratë, ruajnë zakonet dhe gjuhën vllahe.

Përveç popullsisë vllahe të qëndrueshme duhet pasur parasysh se vllahë të tjerë vijnë në verë me bagëtitë e tyre për të populluar kullotat malore. Kjo popullsi endacake që jeton në grupe solide familjesh të plota, me krerët e vet dhe me livadhet e veta duhet të shihet në mënyrë të veçantë nga këndvështrimi ekonomik në qoftë se kihet parasysh se mban gjallë industrinë kryesore vllahe të blegtorisë dhe ato të tjera që rrjedhin prej saj (punishtet e bulmetit, e endjes, e regjies së lëkurave etj.).

Dhe emigrimet e tyre periodike sigurisht do të formojnë lëndë studimi për të gjetur mënyrën e rregullimit të marrëdhënieve që krijojnë midis një shteti dhe tjetrit.

Rregullimi politik dhe administrativ i Krahinës

Krahina vllahe ashtu si gjendej deri pak kohë më parë lidhur me kufijtë e vendosur s' do të mund t'i aneksohej veçse Greqisë apo Shqipërisë. Madje Greqia, gjatë punimeve të Komisionit Ndërkombëtar për caktimin e kufirit jugor shqiptar bëri gjithçka për ta komprometuar mundësinë e një bashkimi me Shqipërinë, duke kërkuar në çdo mënyrë që t'i caktonin ato territore që do të mund të përbënin një urë midis shtetit të ri dhe krahinave vllehe. Këmbëngulja më e theksuar u shfaq madje për copa territori me gjerësi pak qindra metrash.

Ai (bashkimi me Shqipërinë - shën. i përkth.) ishte megjithatë ende i mundur dhe mund të bëhej i tillë akoma më shumë po të merreshin sërish në shqyrtim për këtë qëllim krahinat që mund të futeshin në rrethin e Korçës), duke i shikuar nga pikëpamja e pronës (private dhe shtetërore) të tokave të vendosura në gjuhën e hollë tokësore që tani ndan nga një anë krahinën vllahe të Shqipërisë dhe që u përket në pjesën më të madhe myslimanëve. Sot këto krahina janë pushtuar nga trupat italiane të cilat janë tashmë në kontakt imediat me krahinën vllahe të Pindit dhe mbajnë daljen tregtare më të rëndësishme Korçën.

Çështja e garancive dhe autonomive për t'iu akorduar krahinave kja baza të mira në të tashmen dhe në të kaluarën.

Lidhur me këtë mund të niseshim nga privilegjet që krahinat vllahe kanë gëzuar me leje nga Sulltan Murati (1428-61) dhe me fermane speciale të Vezirit të Madh deri në epokën e Ali Pashë Tepelenës.

Pikat kryesore atëherë ishin:

a) Drejtësia e lartë e administruar nga një kadi në përputhje me ligjet vllahe. E drejta për vllhët të udhëtonin lirisht në tërë Perandorinë duke ushtruar çfarëdo profesioni që t'u pëlqente.

b) Policia e brendshme e krijuar nga vetë vllhët nën përgjegjësinë e udhëheqësve të tyre.

c) Për sa lidhej me policinë e jashtme e drejta për t'u marrë vesh në mënyrë të drejtpërdrejtë për këtë çështje me pashallarët e krahinave të afërme

d) Ndalim për këdo të përzihej në çështjet e tyre fetare

e) Përrjashtim nga çdo taksë për vllhët, po në shenjë vasaliteti t'i çonin çdo vit një (referues apo relacion?) sulltanës Valide

Fermane të tjera speciale lidheshin me privilegje akoma më të mëdha që u jepeshin rrethëve të Mecovës dhe Perivolisë, po kjo lidhur me imunitetin e kohës së lejes dhe jo në harmoni me kohën tonë.

Cilado qoftë zgjidhja që do të gjendet për këtë çështje duhet të merret në shqyrtim fakti se në rastin se do të krijohet një krahinë autonome me territoret e banuara nga arumunët ose edhe thjesht në rastin e një autonomie, imuniteti a privilegje që do t'i akordohen bashkësisë së tyre, garanci për rezultat të mirë do të jetë vetëm të mospërrjashtuarit nga fitimi të asnjërit prej grupeve të cituara më lart në shënimet e tanishme.

*
* *

Shënime politike dhe të qeverisë lidhur me çështjen vllahe dhe me zonën e Pindit

1. Popullsia vllahe e njohur me emërtime të ndryshme (arumunë, vllhë, maqedono-rumunë-cincarë-farsaljotë-sarakaçanë etj.) formon koloni të shpërndara në tërë krahinat e Ballkanit. Ato koloni kanë ruajtur dhe ruajnë gjithnjë veçori etnike dhe fizionomi të veten edhe aty ku disa veçori apo disa lloje veçorish kombëtare humbën pas luftërave të dhunshme për çkombëtarizim që iu desh atyre të duronin sidomos nga ana e propagandës helene, as të mbrojtura, as të mbështetura si u gjendën ato deri në atë kohë të fundit. Këto koloni përbëjnë një shembull të rrallë këmbënguljeje dhe ruajtjeje të racës latine në këto vise dhe janë veçanërisht ato të Ballkanit jugor që e meritojnë vëmendjen tonë sidomos nëse mendohet se ato s'kanë asgjë të përbashkët me ata që u shëmbëllojnë në Rumani, po rrjedhin në vijë të drejtë nga legjionarët e dërguar nga Roma në këto krahina.

2. Kontaktet që maqedono-rumunët e emigruar në Hungari dhe sidomos në Budapest, patën në ato vende me rumunët e Transilvanisë dhe të Rumanisë dhe më vonë studimet e kryera nga politikanë të mërguar apo të arratisur nga Rumania gjatë trazimeve të gjysmës së shekullit të kaluar, politikanë që strehoheshin në vendet e sunduara nga otomanët dhe prandaj patën rast për ta njohur së afërmi këtë gjindje të të njëjtës rasë me ta, zgjuan më vonë në Rumani interesimin për këtë çështje.

Pasi filluan praktikat me qeverinë e Stambollit, në vitin 1864 u hap shkolla e parë e gjuhës rumune dhe në vitet që pasuan disa të tjera dhe që atëherë Rumania s'ka pushuar kurrë veprimtarinë e vet në lidhje me kolonitë vllahe në territorin otoman, nëpërmjet disa ngjarjesh, ngritje dhe ulje të alternuara që kishin si shkak ngjarjet politike, luftërat dhe kontrastet që e kanë trazuar Ballkanin në këto pesëdhjetë vjetët e fundit.

3. Kolonitë vllahe të Ballkanit, në rregullimin e ardhshëm të Gadishullit janë të destinuara për një rol shumë të rëndësishëm ekuilibri politik. Interesimi dhe mbrojtja që u ka munguar në të kaluarën s'do t'u mungojë në të ardhmen, qoftë për ndërhyrjen e drejtpërdrejtë që Rumania i ka siguruar vetes në fushën e traktativave ndërkombëtare, qoftë për vëmendjen që Italia i ka kushtuar kësaj çështjeje me synimin e padyshimtë t'i dalë krah dhe ta mbrojë.

4. Nga kjo pikëpamje fiton një rëndësi të veçantë krahina në të cilën gjenden të grumbulluar vllahët në mënyrë që t'u japin fizionomi të vetën territorit në të cilin jetojnë domethënë krahinën e Pindit dhe të Gramozit.

Kjo krahinë e njohur që nga kohët më të lashta për fizionominë e saj etnike vllahe ka gëzuar gjithnjë autonomi të veçanta, imunitete dhe privilegje të lejuara nga qeveria otomane të ruajtura gjer më 1800, epokë në të cilën dobësia e pushtetit qendror i lejoi Ali Pashait të Janinës të shtrinte pushtetin e vet mbi këto territore duke zhdukur autonomitë që ato kishin gëzuar gjer atëherë.

5. Tani vonë ato territore kanë formuar objekt vëmendjeje ndërkombëtare për hir të studimit të rregullimit më të mirë që të zgjidhet për të garantuar ruajtjen dhe përparimin e popullive me regjim autonomie të gjerë.

6. Shkrimet e shkurtra të parashtruara më lart bashkë me ato të fletës së bashkëngjitur këtu duken të mjaftueshme për të dhënë një ide të konceptuar që duhet të frymëzojnë dhe të rregullojnë qëndrimin qeveritar tonin përballë asaj çështjeje. Ka rëndësi që të gjendet gjithçka që do të mund të lehtësojë, të favorizojë dhe të nxisë formimin dhe konsolidimin e organeve thjesht lokale, domethënë të tilla që të mund të nxirret në pah në çastin e paqes mundësia e jetës autonome të atyre krahinave që mund të përbëjnë një kanton me fizionomi administrative dhe politike të vetën. Ky projekt që s'u realizua dot gjatë traktativave diplomatike që pasuan dy luftërat ballkanike u bë përkundrazi sot lehtësisht i realizueshëm meqenëse u siguria mbështetja e aleatëve të Rumanisë dhe sidomos të Italisë, direkt e interesuar dhe nuk kanë më rëndësi kundërshtimet, rezistencat dhe pengesat që vijnë nga Greqia, e vetmja që

kundërshton realizimin e tij për shkak të synimeve të veta për sundim mbi ato krahina të rëndësishme edhe nga pikëpamja gjeografike ushtarake politike, vargmalesh shumë i rëndësishëm i vendosur në pikën ku e kanë kufirin dhe preken tri raca të ndryshme: shqiptare-greke – bullgare.

7. Si të studiohet dhe të vendoset rregullimi administrativ që do të zbatohet në bazë të kriterëve të lartpërmendur, duhet të nënvizohet se nga pikëpamja e politikës lokale nuk parashikohen vështirësi të rënda. Synimet greke kanë shumë pak mbështetje në vend dhe ruhen nga individë të huaj për vendin dhe nga tepër pak elemente lokale. Çështja e çetave të cilat janë gjithashtu me nënshtrësë helene dhe jo lokale do t'i gjejë edhe ajo një zgjidhje jo të vështirë nëpërmjet një veprë të qetë dhe të urtë qeveritare që t'i qetësojë popullsitë vllahe dhe t'u frymëzojë atyre besim dhe shpresë. Aty ku çeta s'gjen ndihmë dhe mbështetje s'mund të veprojë as të jetojë.

8. Do të ishte e gabuar të mendohej se oficerë dhe funksionarë që s'i njohin fare çështjet, garat, zakonet dhe bazën e tyre historike, do të mund të gjenin papritur rregulla dhe shërim për gjithçka. Dëshira për të vepruar, në këto kushte, do të sjellë rrëmujë, jo rregull.

Është i nevojshëm një bashkëpunim i ngushtë me elementet lokale të cilët janë të vetmit që mund të gjejnë rrugën e drejtë në këtë pështjellim të ngatërruar. Respekti që duhet të shfaqë trupa ndaj njerëzve dhe pasurive nuk mjafton se nuk përbën veçse anën pasive. Ana aktive duhet të bazohet mbi një vijë qëndrimi politik që duhet ta zbatojnë të gjithë. Kjo vijë politike s'mund të sigurohet veçse nga zbatimi strikt i direktivave dhe urdhërave të organit qendror (Komanda e Korparmatës XVI dhe nga vepra e kujdesshme e organeve të zyrës politike së cilës duhet t'i sigurohet çdo lehtësim dhe bashkëpunim dhe duhen shmangur pengesat, përplasjet dhe vështirësitë që mund të krijohen nga nisma pakoordinim dhe, le të na lejohet pa themi, pa njohje dhe nga njëherë, pa mend.

9. Komandanti i trupave i destinuar për të kryesuar ato krahina ka rëndësi të jetë i pajisur me cilësi atërore, i qetë, i prirur për të arsyetuar, jo i prirur për t'u alarmuar apo për të pranuar versione apo interpretime pesimiste të çështjeve të parëndësishme të cilat nganjëherë edhe kur janë reale s'e ndryshojnë asnjë mililitër veprimin e urtë qeveritar që ka synime të largëta.

10. Ka rëndësi që policia të varet nga organet e zyrës politike dhe t'u besohet krejtësisht atyre. Shërbimi i karabinierëve mbretërorë dhe ai i policisë janë dy gjëra krejt të ndryshme.

Le të vlejë shembulli i asaj që bëhet në Itali ku policia nuk varet nga karabinierët mbretërorë, po nga autoritetet politike. Këtu ku ana politike shkëputet nga organet administrative dhe i besohet një zyre të veçantë (zyra politike ushtarake), kjo është aq e nevojshme se vetëm zyra politike është në gjendje për të siguruar qëndrueshmërinë e një linje sjelljeje që, për t'u kuptuar dhe për t'u ndjekur jo vetëm se kërkon një përgatitje të gjatë, po edhe njohjen e lajmeve apo direktivave politike, fshehtësinë e të cilave në ndonjë rast ka

rëndësi ta ruash, dhe prandaj s' duhet të jenë në dorë të organeve vartëse të cilave u takon zbatimi i mençur, jo shtrirja arbitrare e detyrave që është e domosdoshme të ndjekin vetëm një drejtim unik.

11. Ka rëndësi që trupa dhe oficerët të jenë vërtet të bindur që idetë dhe metodat koloniale nuk mund të sjellin aty veçse dëm; dhe do të jetë shumë e lehtë të arrihet ky rezultat, madje të nxirret nga sjellja e tyre e përditëshme një avantazh të madh bashkëpunimi dhe propagande në rast se do t'u shpjegohet atyre që vepra jonë këtu është vepër lartësimi dhe progres moral dhe qytetar, jo për të imponuar një sundim që këto popullsi s'e duan, po për t'i bindur që vetëm nga Italia mund të shpresojmë atë mbrojtje dhe miqësi që është e nevojshme për ta që të sigurojnë evolucionin paqësor etnik dhe kombëtar të luftuar nga kundërshtarët e tyre dhe që vetëm nga Italia mund të shpresojnë ndihmën dhe udhëheqjen që do t'i bëjë ata të arrijnë atë regjim autonomie, lirie dhe pavarësie që bën pjesë në aspiratat e tyre kombëtare dhe që bën pjesë gjithashtu në interesat e mirëkuptuara italiane në këto vende.

12. Duhet parashikuar që pas pushtimit italian të krahinave vllahe qeveria rumune do të thellojë akoma më shumë ato praktika tashmë të shumta dhe të rëndësishme në të kaluarën lidhur me ndihmën dhe tutelën që do t'u jepet rumunë që banojnë në zona të pushtimit tonë. S' duhet përjashtuar që qeveria rumune ashtu si ka afruar oficerë, të ofrojë edhe zyrtarë, sidoqoftë është e sigurt që do të kërkojë dërgimin e mësuesve meqenëse çështja e shkollës ka qenë gjithnjë më xheloze dhe e rëndësishme dhe pikërisht ajo që formoi fillimin e politikës së saj në ato krahina.

Mendimi i të nënshkruarit është që këto dëshira të Rumanisë, në rast se shfaqen, duhen plotësuar për arsyet e mëposhtme:

a) lehtësohet funksionimi dhe konsolidimi i atij regjimit autonom që synohet;

b) cilado qoftë pjesëmarrja e Rumanisë në këtë regjim s' do të mund të vazhdojë të ekzistojë veçse në saj të mbështetjes italiane;

c) të kundërshtosh këto dëshira rumune do të bëjë të lindin dyshime, mosbesim dhe do të komprometonte të ardhmen, pa asnjë avantazh as të tanishëm, as të ardhshëm;

d) të mendosh për ta italianizuar atë krahinë do të ishte projekt i kotë jashtë realitetit dhe në kontradiktë me parimet e respektimit të kombësisë dhe me qëndrimet që tani vonë e kanë vulosur linjën e veprimit të qeverive në luftë me bllokun gjermanik me karakterin e tutelës për të gjitha aspiratat kombëtare;

e) bëhet më i ngushtë bashkëpunimi italo-rumun në Ballkan dhe konsolidohet arsyeja e ekzistencës së tij nëpërmjet shtrirjes së interesimit italo-rumun për tërë kolonitë arumune edhe jashtë zonës autonome të Pindit, kështu që vihen bazat për një punë të ardhshme të përbashkët për të arritur atë rregullim ballkanik që përputhet më shumë me interesat italiane.

Duke përfunduar, gjithçka kontribuon për të krijuar dhe forcuar lidhjet politike midis Italisë, Rumanisë dhe Shqipërisë, do të çojë në rezultate të dobishme dhe të sigurt në të ardhmen.

Unaza ku bashkohen këto interesa politike është zona vllahe e Pindit.

*

* *

Lajme të përmbledhura mbi vllahët e Pindit dhe të Gramozit

Popullsia e racës latine që banon në krahinat që vareshin gjer pak kohë më parë nga Perandoria Otomaner, njihet me emra të ndryshëm. Ajo e quan veten “latina ginte” dhe individët e veçantë po t’i pyesësh e quajnë veten “arumunë”. Disa grupe të tyre kanë emërtime të ndryshme, bie fjala: cicarët (nga cincipesë, mbase pasardhës të ushtarëve të legjionit të pestë), farsaljtët (pasardhës të mundurve të farsaljes, sarakaçanët dhe të tjerë. Turqit i quajnë të gjithë “vllahë” dhe grekët kanë gjetur për ta fjalën “kuco-vllahë” që tingëllon tallëse dhe s’do të duhej të përdorej.

Koloni nga këta arumunë gjenden pak kudo në territoret më parë otomanë dhe fshatrat e tyre dallohen për qëndrueshmërinë dhe një farë elegance në ndërtesat e tyre, për mirësjelljen e banorëve, të qetë, në gjendje, të zënë me tregti apo blegtori dhe për institucionet qytetare të tyre dhe, pra, shfaqin një shkallë progresi më të madhe në krahasim me popullsitë midis të cilave jetojnë, janë vendosur pothuajse gjithmonë në pozicione ushtarake, në nyje malore dhe rrugore që sundojnë luginat dhe komunikacionet.

Po ekzistojnë dy rrethe në të cilat ata janë grupuar në numur të madh dhe të cilave si rrjedhim u japin fizionominë e tyre të veçantë. Dhe sot të paktën njëra prej atyre krahinave mund të quhet vllahe se as puna e çnatyrimin e ndjekur me çdo mjeshtëri dhe çdo mjet nga grekët, as persekutimet, as masakrat kanë arritur ta zhdukin racën.

Këto krahina janë ato që e marrin emrin nga vargmalet e Gramozit dhe të Pindit. Dhe përveç popullsisë së vendosur në mënyrë të qëndrueshme në to duhet marrë parasysh që një tjetër, po aq në numër dhe ndoshta edhe më shumë, e ka selinë aty gjatë stinës së mirë dhe sjell aty grigjën dhe begatinë për të kullotur.

Në krahinën e Gramozit fshatrat dhe qendrat e vogla të banimit të banuara nga vllahët janë dhjetë. Ato gjenden nga ana administrative të gjitha në territorin e sanxhakut të dikurshëm të Korçës, kryeqendër kjo që në pjesën më të madhe është banuar pikërisht nga popullsi të racës rumune. Meqenëse Konferenca e Londrës i caktoi Shqipërisë rrethin e kazasë së Korçës, një pjesë e fshatrave vllahe është bashkuar kështu me shtetin e ri dhe një pjesë tjetër mbeti në krahinat e diskutuara që do të duhej të vizitonte komisioni ndërkombëtar. Emrat e këtyre fshatrave janë ato që pasojnë:

Korçë – Shipiste – Grabovë – Nice – Lanka – Pliasa – Vithkuq – Nikolicë – Moskopi (Voskopojë), Gramosta.

Disa nga këto vise kanë qenë dikur shumë të populluara dhe patën një të kaluar të denjë për t'u përmendur, po në pjesën më të madhe u dogjën dhe u shkatërruan dhe popullsia e tyre emigroi në krahina të tjera sidomos në rrethet e Manastirit dhe në Hungari. Ashtu ndodhi me Moskopolin që numëronte 60.000 banorë, e shkatërruar nga çeta të udhëhequra nga babai i Ali Pashait të Tepelenës; ashtu ndodhi me Nikolicën, Gramostën, Vithkuqin dhe qendra të tjera.

Sot, me gjithëse është fjala ende për fshatra të populluara, s'mund të thuhet se vllahët mbizotërojnë në krahinë, të përzier siç janë me sllavë, shqiptarë dhe pre e përçarjeve fetare dhe politike nga ana e grekëve.

Në krahinën e Pindit gjenden 36 fshatra që kanë ruajtur veçoritë e racës rumune. Ato, sipas relieveve malore dhe luginave që i ndajnë në grupe, mund të renditen si vijon:

Zagori	Vjosë	Dhe Smolikë	Vllahi	Sarandaporos
Kavaleri	Vovusë	Briaza	Baltinon	Furkë
Tretenik	Laku	Armata	Çuçufani	Dançikë
Grebeneti	Paliohori	Pac	Milja (Amenu)	Lupçikë (pjesërisht)
Flamburari	Losnikl	Palioshli	Kanja	Çerazovë (gjithashtu)
Dragari	Dobrinovo	Grizbani	Bablona	
Makrini			Labanikë	
Çerneshi			Perivoli	
Beshin			Avdela	
			Smiksi	
			Samarina	
			Bozovo	

Zona e Mecovës

Mecovë

Votonoshi

Kjarë

I denjë për t'u përmendur është fakti që popullsitë vllahe të krahinës së Zagorisë janë ato që kanë vuajtur më shumë nga propaganda greke. Mbase kontribuoi fakti i skllavërimit që do t'i duhej të duronte ajo krahinë në çdo shfaqje nga ana e Janinës, qendër rrezatimi e veprimi helen.

Fakti është se nën atë trysni ajo popullsi ka humbur shumë nga lidhja afektive ndaj çështjes kombëtare rumune.

Një pjesë e mirë e saj përdor prej shumë vitesh e gati ekskluzivisht gjuhën greke kështu që gjuha vllahe humbet gjithnjë e më tepër rëndësinë e vet.

Është karakteristike dhe për t'u vënë re se në atë krahinë dhe në ato aty afër shumë fshatra përveç atyre të përmendura dhe të cituara më lart, kishin

ruajtur deri në pak vjet më parë karakterin e tyre rumun, ndërsa tani ose s'e kuptojnë me dialektin vllah (Çepelovë, Skammeli, Supuçeli ose e kuptojnë pak (Doliani, Leskovik etj.)

Në krahinën e Vllahisë gjenden fshatrat më të rëndësishëm dhe vllahë të kulluar, nga të cilat disa (Samarina, Avdela, Perivoli) shumë të rëndësishëm dhe të populluar aq sa formojnë ata vetë pak më shumë se gjysmën e popullsisë së tërë kazasë së Grebenes në të cilën gjenden. Popullsia ka ruajtur tërë veçoritë etnografike në shkallë të lartë dhe është shumë e lidhur me çështjen kombëtare rumune. - Gjuha greke flitet vetëm nga pak veta dhe është krejt e panjohur për shumicën.

Këto popullsi kanë zhvilluar vjet me radhë një luftë të egër kundër trysnive dhe prepotencave helene, duke arritur madje në përdorimin e çetave kombëtare të armatosura kundër atyre që propaganda greke çonte në Pind për të terrorizuar krahinën, gjë kjo shumë e çuditshme, po qe se mendohet për traditat paqësore dhe të buta të gjindjes vllahe.

Pikërisht në sajë të tyre dhe të krimeve të kryera atje nga çetat greke (masakër e Avdelës) që çështja e përgjithshme vllahe arriti para pak vjetëve në shkallën më të lartë të ashpërsimit dhe e çoi Rumaninë që të përfundonte veprën e saj në favor të autonomive vendase për vllahët otomanë duke kompromentuar madje marrëdhëniet e saj me Greqinë.

Të njëjtat pohime mund të bëhen për fshatrat e shpatit jugor të masivit të Smolikës ndonëse popullsitë e tyre nuk e shfaqin lidhjen e tyre shpirtërore [me çështjen vllahe] po në atë shkallë.

Në përgjithësi mund të thuhet që tërë popullsia vllahe e ndjen origjinën e vet të ndryshme nga ajo e popullsive që e rrethojnë dhe që kudo, sidomos gratë, ruajnë zakone dhe gjuhë vllahe.

Përveç popullsisë vllahe të qëndrueshme dhe të vendosur në vend, duhet pasur parasysh që po aq vllahë vijnë në verë me bagëtitë e tyre për të populluar kullotat malore. Kjo popullsi endacake që jeton në grupe kompakte familjesh të plota, me udhëheqësit e vet dhe me priftërinjtë e vet duhet madje të çmohet në mënyrë të veçantë nga pikëpamja ekonomike po qe se mendohet se e mban gjallë industrinë kryesore vllahe të blegtorisë dhe të tjerat që rrjedhin s'andejmi (punishtet e bulmetit, endja, regjja e lëkurëve etj.).

Dhe emigrimet e tyre periodike sigurisht që duhet të formojnë lëndë studimi që të gjendet mënyra për të rregulluar marrëdhëniet që krijojnë ato midis shteteve.

Burimi: *Archivio Storico Diplomatico di Ministero Affari Esteri*, Roma (më tej: *AMAE*), Fondi: Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Pacco 7, image 2147.

*

* *

Paris, 30 shtator 1918

Objekt: Rumunët e Ballkanit

Vula e Ministrisë së Punëve të Jashtme

Zoti Ministër,

Kam nderin që t'i transmetoj Shkëlqesisë Suaj letrën e bashkëngjitur këtu që më ka drejtuar prof. Xhorxho Murmu, rumun nga Epiri, profesor në Universitetet e Bukureshtit dhe të Jasit dhe anëtar Komisionit të dërguar jashtë shtetit për propagandën rumune.

Zoti Murnu që i është kushtuar çështjes së rumunëve të Ballkanit dhe që ka qenë në marrëdhënie me Qeverinë Mbretërore në epokën e luftës Ballkanike, mbron antralizimin në Shqipëri të elementit latino-rumun, aktualisht të shpërndarë jo vetëm në Shqipëri, po në Maqedoni, Serbi, Greqi dhe Epir. Ky centralizim, sipas mendimit të tij, do të lehtësohej shumë prej pushtimit aktual nga ana jonë të Shqipërisë së jugut.

Zoti Murnu më është rekomanduar me shumë ngrohtësi në rrugë personale nga ky Ministër i Rumanisë, zoti Krecian.

Pranoi, zoti Ministër, dëshminë e konsideratës sime më të lartë.

Firma

Shkëlqesisë së Tij

Ministrit të Punëve të Jashtme - Romë

Burimi: *Archivio Politico, Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Pacco 38 (marrë nga Arkivi i Institutit të Historisë, img. 2885-2886)*

*

*

*

Ministria e Punëve të Jashtme

Tel. nr. 459

Adresuar: Legatës Mbretërore Italiane

Romë, 9 prill 1917, ora 16

Komanda e Vlorës siguron që, sipas udhëzimeve të marra, do të rregullojë gjërat në mënyrë që popullsive kucovllahe t'u jepet gjithë ndihma e mundshme prej autoriteteve tona.

Firma Sonino

Burimi: *Archivio Politico, Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Pacco 38 (marrë nga Arkivi i Institutit të Historisë, img. 2888)*

*

*

*

Ministria e Punëve të Jashtme
 Tel. nr. 459
 Adresuar: Legatës Italiane në Jasi
 Dëshifroi: G. Manzoni
 Telegrami Juaj N.116

Romë, 6 prill 1917, ora 23

Qysh në tetorin e shkuar me kërkesën e Ministrit Rumun në Athinë e porosita Komandën Ushtarake në Vlorë që t'i japë mundësisht ndihmë popullsive kucovllahe. E përsëris porosinë (.). I yti [?] Bracianu

Firma Donelli (?)

Burimi: *Archivio Politico, Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Pacco 38* (marrë nga Arkivi i Institutit të Historisë, img. 2890)

*
* *

Parë nga shefi i zyrës së shifrës - Garbaso
 Legatës Mbretërore, Jasi
 Kopja nr.10

Romë, 3 prill 1917, ora 14.40, 7.30

110 Sipas kërkesës së Ministrit Rumun në Athinë dhe duke pasur parasysh përparimin e trupave italiane në Epir i rekomandoj nxehtësisht Qeverisë Mbretërore kuco-vllehët që banojnë atje dhe që janë persekutuar aq shumë nga grekët.

Fasciotti

Burimi: *Archivio Politico, Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Pacco 38* (marrë nga Arkivi i Institutit të Historisë, img. 2892)

*
* *

Ministria e Punëve të Jashtme
 Telegram i nisur IV 2353
 Adresuar te Komanda Vlorë

Romë 13.....[e palexueshme] ora 24

Telegrami im 2236 i shkaktuar ekskluzivisht nga telegrami i Ministrit në Athinë i kopjuar brenda tij (.)

Mbështetja e popullsisë vllehe e kërkuar nga Ministri rumun në Athinë duhet të kuptohet në mënyrë të përgjithshme.

Sonnino

Burimi: *Archivio Politico, Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Pacco 38* (marrë nga Arkivi i Institutit të Historisë, img. 2893)

*
* *

Ministria e Punëve të Jashtme
Tel. nr. 2236
Adresuar te Komanda e Trupave të Pushtimit Vlorë
I dërguar nga Lopez

Romë, 13 tetor 1916 ora 22

Ministri Mbretëror në Athinë telegrafon sa vijon:
Teleg. N. 4246/387

I rekomandoj Shkëlqesisë Suaj dëshirën e qeverisë rumune për rastin a do të ketë mundësi t'i jepet mbështetja e kërkuar popullsisë kuçovllahe.

Sonnino

Burimi: *Archivio Politico, Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Pacco 38* (marrë nga Arkivi i Institutit të Historisë, img. 2894)

*
* *

Për: Shefi i zyrës së shifrës - Forlani
Legatës Mbretërore Athinë

*Athinë, 11 tetor 1916 ora 6
Romë, 11 tetor 1916 ora 15*

Kabineti N.

Ky Ministër i Rumanisë më ka komunikuar telegramin që pason të drejtorit të shkollës (?) rumune Korçë.

Qeveria Bullgare në zonën e pushtuar ushtarakisht pranë Korçës ka konfiskuar të gjitha pasuritë e rumunëve që banonin në fshatrat e Doplearos

Daismicës dhe Korçës që konsistonin në dele, kuaj, të korrat. Dëmet tejkalojnë treqindmijë liretat.

Ministri i Rumanisë u lutet autoriteteve ushtarake italiane që mundësisht të përpiqen t'i mbrojnë rumunët e atyre krahinave.

Bozdari

Burimi: *Archivio Politico, Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Pacco 38* (marrë nga Arkivi i Institutit të Historisë, img. 2895)

*

* *

Ministria e Punëve të Jashtme

Tel. nr. 2082

Adresuar te Konsullata Italiane Janinë

Telegrami juaj n. 3886 të datës 5 në vijim

Romë, 15 shtator 1916, ora 21

Për shkak të konsideratave të ndryshme s'është e mundur të pranohet kërkesa e bërë nga kuco-vllehët për të marrë kombësinë italiane (.) Qeveria italiane megjithatë do të përpiqet gjithnjë në marrëveshje me qeverinë rumune për të përmirësuar dhe për ta bërë të sigurt fatin e kucovllahëve në Epir dhe në Greqi.

Sonnino

Burimi: *Archivio Politico, Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Pacco 38* (marrë nga Arkivi i Institutit të Historisë, img. 2896)

*

* *

Ministria e Punëve të Jashtme

Tel. nr. 2083

Adresuar te: Legata Mbretërore Italiane - Bukuresht

Romë, 15 shtator 1916, ora 21

Konsulli Mbretëror në Janinë telegrafon "Përparimi i italianëve në Epir... përgjigja që duhet t'u jepet atyre.

Riprodhim i telegramit të Janinës 3896/190

Jam përgjigjur si vijon:

“Për arsye të ndryshme s’është e mundur të pranohet kërkesa e kucovllahëve për të marrë kombësinë italiane. Megjithatë qeveria italiane do të përpiqet gjithnjë në marrëveshje me qeverinë rumune për të përmirësuar dhe siguruar fatin e kuco-vllahëve në Epir dhe në Greqi.

Kjo që i komunikoj tani Shkëlqesisë Suaj më duket një lajm me vend.

Sonnino

Burimi: *Archivio Politico, Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Pacco 38* (marrë nga *Arkivi i Institutit të Historisë*, img. 2898)

*

* *

Përktheu: **Klara KODRA**
Përgatiti për botim: **Beqir META**

(Vijojnë në numrin e ardhshëm)

